



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. V-160 Prot.

Tiranë, më 12/09/2022

URDHËR

Nr. 425, datë 12 / 09 2022

**“PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË LICENCËS SË USHTRIMIT TË
PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES VIOLA SHKURTI”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noterja Viola Shkurti, e cila e ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 332/1 datë 17.01.2017, në Rrethin Gjyqësor Gjirokastrë, në njësinë administrative Dropull i Sipërm, nëpërmjet shkresës me nr. V-135 Prot., datë 01.08.2022, ka paraqitur kërkesën e saj për pezullimin e licencës së noterit, për periudhën 01.08.2022-01.08.2023, duke qenë se është shpallur fituese në konkurimin për punësim në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Pogradec.

Referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht, në gërmën “c”, të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se, *“Noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohësisht, për arsyt e mëposhtme ... c) zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik”*. Gjithashtu, në paragrafin e dytë të po këtij neni, parashikohet se, *“Në rastin e zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik, periudha e pezullimit është sa kohëzgjatja e funksionit publik”*.

Bazuar në pikën 3, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës”*, Dhoma Kombëtare e Noterisë, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë nesh me nr. V-135/3 prot., datë 29.08.2022, shpreh dakordësimin për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë noteriale të noterës Viola Shkurti për periudhën e sipërcituar.

Në vijim me shkresën nr. V-135/2 prot., datë 29.08.2022, Dega Vendore e Noterisë Gjirokastrë, ka propozuar emrin e noterës Vangjeli Marko për të marrë në administrim arkivën noteriale të noterës

Viola Shkurti, si dhe noterin Ermal Aliko si përfaqësues të Degës Vendore Gjirokastrë, në Komisionin e Dorëzimit të Arkivit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të germës “c”, pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:


1. Pezullimin e përkohshëm të licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Viola Shkurti, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Gjirokastrë, deri më datë 01.08.2023.
2. Caktimin e noteres Vangjeli Marko për administrimin e arkivës noteriale, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Hyri Ramaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste e ngarkuar me kryerjen e detyrave pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Z. Ermal Aliko, përfaqësues nga Dega Vendore e Noterisë Gjirokastrë.
4. Lënien në ruajtje pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë, të vulave respektive, vulën e thatë dhe vulën e njomë, të noteres Viola Shkurti, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të licencës;
5. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit menjëherë pasi të njihet me këtë urdhër, të caktoj datën dhe orën e dorëzimit të arkivit, si dhe të njoftoj noterin znj. Viola Shkurti 5 (pesë) ditë përpara për datën dhe orën e caktuar.
6. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
7. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në

Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
10. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

